

## Ndryshimet në legjislacion

Shkurt 2017

### Në këtë publikim:

- Ligji Nr. 05/L -119 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike;
- Ligji Nr. 05/L -116 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115 dhe Nr. 04/L-168;
- Ligji Nr. 05/L-100 për Ndhmën Shtetërore;
- Ligji Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë;
- Ligj nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës;
- Rregullore (MPMS) Nr. 05/2016 për Kërkesat Minimale për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë të Punësuarve në Risk nga Ambientet Shpërthuese;
- Rregullore (MPMS) Nr. 06/2016 për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë me Pajisje me Ekran Shfaqës;



### I. Ligji Nr. 05/L -119 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-043 Për Faljen e Borxheve Publike

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Faljen e Borxheve Publike u publikua ne Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më datë 19 janar 2016 dhe ka hyrë në fuqi në datën e publikimit.

Qëllimi i këtij Ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike (ligji bazik), me qëllim të vendosjes së afatit të ri ligjor për përfitimin nga falja e borxheve, sipas dispozitave të ligjit bazik.

Me këtë ligj definicioni i Person-it është si në vazhdim:

*"për qëllime të këtij ligji, nënkupton të gjithë personat fizik dhe juridik (përveç Ndërmarrjeve Shoqërore nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit) që kanë shuma të borxheve publike të pa shlyera ndaj Institucioneve shtetërore dhe Ndërmarrjeve publike."*

Gjithashtu ky ligj definojnë që subjektet mund të përfitojnë nga falja e borxheve publike, dhe që këtë të drejtë mund ta realizojnë vetëm deri më datë 1 shtator 2017.

### II. Ligji Nr. 05/L -116 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-101 Për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115 dhe Nr. 04/L-168;

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Fondet pensionale u publikuar ne Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më datë 17 janar 2017, dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit.

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115 dhe Ligjin 04/L-168, (në tekstin e mëtejshëm: ligji bazik).

Ky ligj ndryshoi procedurën e emërimit të Bordit Drejtues, kohen e mandatit 4 vjeçar dhe të drejtën për tu rizgjedhur.

Gjithashtu, ky ligj parasheh që Fondi në bashkëpunim me Administratën Tatimore të Kosovës në vazhdimësi zhvillon aktivitete për identifikimin e kontributeve të paidentifikuara. Në rast se për kontributet përkatëse nuk identifikohen pagesit nga ana e Fondit dhe nuk ka as lajmërim nga ana e vet pagesve deri në gjashtë (6) vjet nga viti i pagesës, atëherë

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka të drejtën e marrjes së vendimit për inkasimin e Fondeve përkatëse në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Një vendim përkatës merret vetëm pasi që Bordi i Fondit të ketë informuar me shkrim Qeverinë që ka shtjerrë të gjitha mundësitë e identifikimit të pagesve të kontributeve përkatëse.

Në rast të identifikimit të pagesve të kontributeve pas afatit gjashtë (6) vjeçar, mjetet e inkasuara sipas përshkrimit më lartë i kthehen Fondit, së bashku me kamatën ekuivalente me fitimin mesatar që ka pasur Fondi gjatë kësaj periudhe.

Më tutje, të punësuarit e huaj me qëndrim të përkohshëm në Kosovë, të cilët nuk kanë qenë të obliguar të paguajnë kontribute pensionale, dhe nuk janë të obliguar të kontribuojnë me ligjet në fuqi, mund t'i tërheqin mjetet e tyre të akumuluar me anë të një pagese të vetme.

Bordi drejtues në FKPK apo në një Fond plotësues pensional themelon komitetin e auditimit, anëtarët e të cilit zgjidhen në mesin e bordit drejtues dhe ekspertëve të jashtëm. Shumica e anëtarëve të komitetit të auditimit janë anëtarë të bordit drejtues. Së paku një anëtar i komitetit të auditimit duhet të jetë ekspert i jashtëm në fushën e kontabilitetit ose auditimit, i cili është i pavarur nga menaxhmenti dhe Bordi drejtues.

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, mandati i anëtarëve aktual të Bordit Drejtues vazhdon deri në skadimin e mandatit të tyre të përcaktuar me Vendimin nr. 04-V-840, datë 6 maj 2014 dhe Vendimin nr.05-V-164, datë 30

nëntor 2015, të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

### **III. Ligji Nr. 05/L-100 Për Ndhimën Shtetërore**

Ligji Nr. 05/L-100 për Ndhimën Shtetërore u publikua ne Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më datë 17 janar 2017, dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit.

Me këtë ligj përcaktohen parimet dhe procedurat, kushtet e përgjithshme si dhe rregullat për autorizimin, monitorimin dhe revokimin e ndihmës shtetërore dhe është pjesërisht në përputhje me Rregulloren e BE-së 2015/1589, e datës 13 korrik 2015, për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 108 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian.

Dispozitat e këtij ligji janë të detyrueshme për të gjithë sektorët e prodhimit dhe shërbimeve që veprojnë në Republikën e Kosovës, me përjashtim të sektorëve të agrikulturës dhe të peshkimit.

Ky ligj shfuqizon Ligjin Nr. 04/L-024 për Ndhimën Shtetërore.

Ndërsa aktet nënligjore të miratuara për zbatimin e Ligjit Nr. 04/L-024 për Ndhimën Shtetërore do të mbeten në fuqi nëse nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, derisa të shfuqizohen me aktet nënligjore të reja.

### **IV. Ligji Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë**

Ligji për Akademinë e Drejtësisë u publikua më datë 08 Shkurt 2017 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit.

Me këtë ligj themelohet Akademia e Drejtësisë dhe rregullohet statusi, funksionet dhe organet e saj, mënyra dhe kushtet sipas të cilave kryhet trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të Republikës së Kosovës, trajnimi i personelit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe çështje të tjera në pajtim me ligjin.

Akademia është institucion publik i pavarur me cilësinë e personit juridik, ka buxhetin e saj, i cili administrohet në mënyrë të pavarur në pajtim me ligjin, dhe selia e Akademisë është në Prishtinë.

Organet e Akademisë janë:

Këshilli Drejtues, Këshilli Programor dhe Drejtori Ekzekutiv.

Akademia organizon trajnim fillestar për aftësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të sapo emëruar.

Sipas kërkesave të institucioneve kompetente dhe varësisht nga mundësitë, Akademia mund të organizoj trajnime, duke përfshirë, por pa u kufizuar, për:

- avokatë shtetëror;
- avokatë;
- noterë;
- përmbarues privat;
- ndërmjetësues;
- administrator falimentues.

Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr.02/L-25 për Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Viti III/ nr. 23/ 1 Prill 2008.

## **V. Ligj nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës**

Ligji për Investimet Strategjike u publikua më datë 08 Shkurt 2017 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit.

Ky ligj ka për qëllim nxitjen, tërheqjen dhe krijimin e kushteve për realizimin e investimeve strategjike në Republikën e Kosovës, si dhe përcaktimin e procedurave administrative dhe kriterëve për vlerësimin, zgjedhjen, implementimin dhe mbikëqyrjen e projekteve strategjike, si dhe përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së Republikës së Kosovës për qëllim të zbatimit të projekteve për investime strategjike.

Institucionet dhe autoritetet e Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij ligji do të respektojnë parimet e lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, parimet të konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë, parimit të mos-diskriminimit, transparencës, proporcionalitetit dhe respektit reciprok.

Ky ligj mbështet në parimet dhe kushtet e përcaktuara në legjisllacionin e zbatueshëm për ndihmë shtetërore, dhe ato që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.

Statusi i investimit strategjik ose projektit investues strategjik mund të fitohet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me Ligj, për projektet nga sektorët prioritar të zhvillimit ekonomik e social të cilët i kontribuojnë rritjes ekonomike, punësimit dhe zbatimit të teknologjive të reja, rritjes së aftësisë konkurruese të ekonomisë së Kosovës, rritjes së eksportit dhe zvogëlimit të deficitit tregtar dhe që përgjithësisht ndikojnë në rritjen e mirëqenies dhe të kushteve të jetesës së qytetarëve të Republikës së Kosovës në sektorët si:

- Energji me infrastrukturë dhe miniera;
- Transport dhe telekomunikacion;
- Turizëm;
- Industri përpunuese;
- Bujqësi dhe industri ushqimore;
- Shëndetësi;
- Parqe industriale dhe teknologjike;
- Administrim i ujërave të zeza dhe mbeturinave.

Ky ligj zbatohet për investimet strategjike, të cilat parashikohen të realizohen në Republikën e Kosovës, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Pas propozimit nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Qeveria e Republikës së Kosovës nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga hyrja në fuqi të këtij ligji.

## **VI. Rregullore (MPMS) Nr. 05/2016 për Kërkesat Minimale për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë të Punësuarëve në Rrezik nga Ambientet Shpërthyes**

Kjo Rregullore është protokolluar me datën 20 dhjetor 2016 dhe ka hyrë në fuqi shtatë (7) ditë nga data e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Qëllimi i kësaj rregullore është që të caktoj kërkesat minimale në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtorëve në rrezik nga ambientet shpërthyes. E njëjta rregullore është në harmoni me Direktivën 1999/92/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 16 dhjetor 1999 mbi kërkesat minimale për përmirësimin e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë së punonjësve në rrezik të mundshëm/potencial nga ambientet shpërthyes.

Aplikimi i kësaj rregullore shtrihet tek të gjitha ndërmarrjet dhe vendet e punës që janë brenda fushëveprimit të Ligjit nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, pavarësisht formës së organizimit, formën e pronësisë dhe arsyeve për të cilat kryhen punët apo trajnimet.

Të përjashtuara nga aplikimi i kësaj rregullore janë, përfshirë por jo kufizuar në:

1. Zonat që shërbejnë drejtpërdrejt për trajtimin mjekësor të pacientëve;
2. Përdorimin e pajisjeve që punojnë me lëndë djegëse të gazta;
3. Industrinë e nxjerrjes së mineraleve;

Rregullorja përcakton obligimin e punëdhënësit që të siguroj parandalimin dhe mbrojtjen kundër shpërthimeve duke ndërmarrë masat teknike dhe organizative të përshtatshme për natyrën e procesit të punës, në përputhje me parimet bazë të listuara më poshtë sipas rëndësisë:

1. Të parandalojë krijimin e ambienteve shpërthyes, ose ku natyra e veprimtarisë nuk e lejon këtë;
2. Të shmangë ndezjen e ambienteve shpërthyes; dhe
3. Të zvogëloj efektet negative të një shpërthimi në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e punëmarrësve dhe personave të tjerë.

Kur është e nevojshme, masat e lartpërmendura parandaluese do të kombinohen dhe/apo plotësohen nga masat tjera kundër përhapjes së shpërthimeve. Punëdhënësi është i obliguar që të rishikoj rregullisht masat parandaluese dhe mbrojtëse në perioda të caktuara nga vetë ai.

Sipas kësaj rregullore, punëdhënësi duhet të vlerësoj çdo rrezik që mund të ngritet nga ambientet shpërthyes dhe duhet të ketë parasysh të paktën këto, por jo kufizuar në,:

1. Mundësinë e krijimit të ambienteve shpërthyes dhe qëndrueshmërinë e tyre;
2. Instalimet, substancat e përdorura, proceset dhe ndërveprimet e tyre të mundshme.

Përpos tjerash, punëdhënësi duhet të klasifikoj vendet ku ambientet shpërthyes mund të krijohen në zona dhe duhet të siguroj që kërkesat minimale të caktuara nga kjo rregullore janë të aplikuara në mënyrë që të

sigurohet siguria dhe shëndeti i punëmarrësve dhe personave të tjerë.

Në vende të tilla ku ambientet shpërthyes mund të krijohen deri në atë masë sa të rrezikojnë sigurinë dhe shëndetin e të punësuarit, punëdhënësi duhet të siguroj mbikëqyrje dhe/apo monitorim të vazhdueshëm duke përdorur masat e përshtatshme teknike gjatë pranisë së të punësuarit.

Rregullorja specifikon obligimin për përpilim apo rifreskim të Dokumentit për Mbrojtje nga Shpërthimi, i cili duhet të përfshijë, por edhe kufizuar në:

1. Përcaktimin dhe vlerësimin e riskut për shpërthim;
2. Marrjen e të gjitha masave të përshtatshme parandaluese dhe lehtësuese/përmirësuese;
3. Koordinimin e masave dhe procedurave sipas dispozitave të kësaj rregullore;

Dispozitat e kësaj rregullore janë shtjelluar më tej në tri shtojcat të cilat janë të bashkangjitura në këtë rregullore, dhe që janë pjesë përbërëse e kësaj të fundit.

## **VII. Rregullore (MPMS) Nr. 06/2016 për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë me Pajisje me Ekran Shfaqës**

Kjo Rregullore është protokolluar me datën 20 dhjetor 2016 dhe ka hyrë në fuqi shtatë (7) ditë nga data e nënshkrimit nga Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Qëllimi i kësaj rregullore është caktimi i kërkesave minimale për punën me pajisje me ekran shfaqës. E njëjta rregullore është në harmoni me Direktivën e Këshillit Nr. 90/280/EEC e datës 29 maj 1990 për kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë për punën me pajisje me ekrane shfaqëse.

Aplikimi i kësaj rregullore shtrihet tek të gjitha ndërmarrjet dhe vendet e punës që janë brenda fushëveprimit të Ligjit nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, pavarësisht formës së organizimit, formën e pronësisë dhe arsyeve për të cilat kryhen punët apo trajnimet.

Rastet kur kjo rregullore nuk aplikohet përfshijnë, por nuk kufizohen në:

1. Pajisjet me ekran shfaqës në kabinat e shoferëve ose kabinat e kontrollit për automjetet ose makineritë;
2. Sistemet kompjuterike të cilat janë kryesisht për përdorim publik;
3. Pajisjet "lëvizëse" me ekran shfaqës jo me përdorim të zgjatur në një vend individual pune.

Sipas kësaj rregullore, punëdhënësi ka për obligim që të kryej një analizë të vendeve individuale të punës për vlerësimin e kushteve të sigurisë dhe shëndetit për punëmarrësit, posaçërisht në rastet ku ka rrezik për lodhje të shikimit, fizike apo psikike. Punëdhënësi duhet të marrë masat e përshtatshme për të përmirësuar kushtet e punës dhe të zvogëloj apo të shmangë rreziqet e tilla që gjenden përmes vlerësimit të lartpërmendur.

Punëdhënësi duhet të ndërmarrë hapat e përshtatshëm për të siguruar që vendet e punës janë në përputhje me kërkesat e kësaj rregullore.

Punëdhënësi është i obliguar që t'i njoftoj të punësuarit për të gjitha aspektet e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës me pajisje me ekran shfaqës si dhe për çdo masë sigurie apo shëndeti të ndërmarrë në përputhje me këtë rregullore.

Punëdhënësi është i obliguar që të ofroj teste të përshtatshme të syrit dhe shikimit nga një specialist i fushës për të punësuarit para fillimit të punës me ekrane shfaqëse, në intervale të rregullta pas fillimit të punës me ekrane shfaqëse (së paku një herë në një deri në tre vite) dhe në rast se të punësuarit kanë vështirësi në shikim që mund të jetë pasojë e punës me ekrane shfaqëse.

Në rastet kur të punësuarit kanë probleme shëndetësore që lidhen me punën me ekrane shfaqës, punëdhënësi është i obliguar që të siguroj kontrollin mjekësor muskuloskeletal, neurologjik ose të sistemit venoz.

Dispozitat e kësaj rregullore janë shtjelluar më tej në shtojcën e cila është e bashkangjitur në këtë rregullore, dhe që është pjesë përbërëse e kësaj të fundit.

## Kontaktet e Deloitte:

### **Afrore Rudi**

Drejtoreshë | Shërbime Tatimore & Ligjore  
Deloitte Kosova sh.p.k.  
Rr. Ali Hadri p.n., 10000  
Prishtinë, Republika e Kosovës  
Mob: +386 (0)49 590 807  
Email: [arudi@deloittece.com](mailto:arudi@deloittece.com)

### **Luljeta Plakolli - Kasumi**

Menaxhere | Shërbime Ligjore  
Deloitte Kosova sh.p.k.  
Rr. Ali Hadri p.n., 10000  
Prishtinë, Republika e Kosovës  
Mob: +386 (0)49 780 769  
Email: [lplakollikasumi@deloittece.com](mailto:lplakollikasumi@deloittece.com)

## **Përrjashtim i përgjegjësisë:**

Ky publikim përmban vetëm informacion të përgjithshëm dhe asnjëra nga firmat anëtare apo filialet e Deloitte Touché Tohmatsu Limited (së bashku referohen si "Deloitte Network") përmes këtij publikimi ofrojnë këshilla apo shërbime profesionale për kontabilitet, biznes, financiare, investime, ligjore, tatimore apo këshilla dhe shërbime tjera profesionale.

Ky publikim nuk është zëvendësim i shërbimit apo këshillës profesionale, dhe nuk duhet të përdorur për të marr ndonjë vendim që mund të ndikonte financat e biznesit tuaj. Para se të merrni ndonjë vendim apo veprim që do të mund të ndikonte në financat e biznesit tuaj, ju duhet të konsultoheni me një këshilltar profesional dhe të kualifikuar. Asnjë entitet i rrjetit të Deloitte nuk do të konsiderohet përgjegjës për ndonjë humbje të pësuar duke u bazuar në këtë publikim.

\*\*\*

Deloitte i referohet një ose më shumë firmave të Deloitte Touché Tohmatsu Limited, një kompani private britanike e kufizuar nga garancitë dhe firmave të saj anëtare. Secila nga këto firma përfaqëson një entitet ligjor të ndare dhe të pavarur. Përshkrimin e detajuar të strukturës ligjore të organizatës Deloitte Touché Tohmatsu Limited dhe firmave të saj anëtare e gjeni në adresën [www.deloitte.al/about](http://www.deloitte.al/about).

Deloitte ofron shërbime në fushat e auditimit, taksës, konsulencë dhe konsulencë financiare klientëve si privat dhe publik në të gjitha industritë që ata operojnë. Në sajë të një rrjeti të lidhur ndërkombëtar të firmave anëtare në më shumë se 150 vende, Deloitte sjell mundësi të klasit të parë botëror dhe shërbime me kualitet të lartë për klientët, duke dhënë njohuritë tek ata që i adresojnë sfidat më komplekse. Pothuajse 244,400 profesionistë angazhohen që Deloitte të jetë etaloni i përsosmërisë.

© 2017 Deloitte Kosova sh.p.k